



VENDIMI ëSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNO-SNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ / UROŠEVAC

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr. 787/16

Më
Dana

31. 07. 2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM-

DIVIZIONI PENAL, gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren Hysnije Gashi, si dhe me zyrtaren ligjore, Albana Ujupi, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED], për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 të KPK-së, sipas akuzës së Prokurorisë Themelore - në Ferizaj, PP.nr.1761-2/13 të datës 03.07.2014, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Rafet Halimi, të akuzuarit [REDACTED], pas mbajtjes së shqyrimit gjyqësor me datën 06.06.2017, mori dhe shpalli publikisht, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED] nga Ferizaj, rruga [REDACTED] i lindur me datë 1 [REDACTED] në të njëtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe eëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] baba i një fëmije, me profesion mbledhës i hekurishtave, gjendja e mesme ekonomike, me numër personal [REDACTED]

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 16.08.2013, rrëth orës 19.00, në Ferizaj, në rrugën “Driton Islami”, afér pompës së derivateve “Hib Petroll”, pas në mosmarveshje lidhur me bllokin e rrugës, fillon konflikti verbal e më pas ku i pandehuri del nga vetura e tij dhe me në thikë – mjet të rrezishëm që mund të shkaktoj lëndim te rëndë trupor dhe e godet të dëmtuarin [REDACTED] [REDACTED] në dorën e djathtë kurse të dëmtuarin [REDACTED] e godet me grushta dhe shqelma në pjesë të ndryshme të trupit.

Me këtë ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni, 188 par.2 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4,7, 17, 21, 41, 43, 45, 47, të KPRK-ës dhe nenit 365 të KPPRK-ës, i

SHQIPTON

DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 1/një /MUAJ, i cili dënim me pëlqimin e te te dënuarit konform nenit 47 par. 1 të KPRK-së i zëvendësohet me dënim me gjobë, në lartësi prej 300/treqind / €, i cili është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse dënimi i zëvendësuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të paraparë me nenin 46 par. 3 të KPRK, do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 € do të vuaj një ditë burgimi.

Të dëmtuarit [REDACTED] dhe R [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të pashallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30/tridhjet /€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Kjo gjykate me aktgjykimin e saj P.nr.772/14 te datës 13.10.2015, ka shpall fajtore te

Akuzuarin [REDACTED] duke i shqiptuar dënim DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 1/një /MUAJ, i cili dëni konform nenit 47 par. 1 të KPRK-së i zëvendësohet me dënim me gjobë, në lartësi prej 300/treqind / €, i cili është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Gjykata e apelit me aktvendimin e saj P1.nr. 586/2016 te datës 07.07.2016 e ka aprovuar ankesën e te akuzuarit [REDACTED] i ashtu që e ka anuluar kete Aktgjykim dhe çështjen e ka kthyer ne Rigjykim .

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i përgjithshëm , ka paraqitur aktakuzën PP.II nr.1761-2/13 te datës 03.07.2014, kundër të akuzuarit [REDACTED], për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga nen 188 par.2 të KPRK-ës.

Gjykata , duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësore me datë 06.06.2017, në të cilin shqyrtim i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së duke shtuar se me të dëmtuarit jemi pajtuar dhe se pas rastit i cili ka ndodhur e kemi kuptuar se jemi miq se për këtë vepër është penduar thellë, se duke premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, duke e lutur gjykatën që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

-i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit,

-pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,

-pranimi i fajit mbështetët në faktet e çështjes që përban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendet

Meqenëse e pandehura ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari, konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 të KPRK-së.-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të neni 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se nga evidenca e të dënuarve rezulton se i akuzuari është i padënuar me ndonjë aktgjykim të formës prerë , pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, në mungesë të rrethanave veqanarisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të te pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, te pandehurit i vërtetoi

dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi , me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në propcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjesë së vepres penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe përsoshat e të pandehurit.

Konform nenit 463 par.2 të KPPK-së, të dëmtuarit, [REDACTED] dhe [REDACTED]
[REDACTED] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 450 par.2 nën par.2.6 dhe par.3 dhe nenit 451 të KPPRK-së, i pandehuri obligohet që në emër të pashallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 euro, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr.787/16 te datës 06.06.2017.

Zyrtarja Ligjore ,

gjyqtarja,

Albana Ujupi

Hysnije Gashi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.